

PAVE

Parandalimi dhe adresimi i ekstremizmit të dhunshëm përmes rezistencës së komunitetit

Pasqyrë Politikash për Kosovën



Projekti PAVE ka siguruar financimin nga Programi i Bashkimit Evropian për hulumtime e inovacion Horizon 2020, sipas marrëveshjes së grantit nr. 870769.




Prezantim i Projektit PAVE

Projekti hulumtues PAVE (2020-23) ka mbledhur njohuri të bazuara në prova mbi tendencat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut (MENA), si dhe Ballkanin Perëndimor. Qëllimi i tij është të përforcojë kapacitetet e politikëbërësve dhe prijësve të komuniteteve për zhvillimin e një strategjie efektive parandaluese midis Bashkimit Evropian dhe fqinjëve të tij. Krahas raporteve kërkimore dhe pasqyrave të politikave, mjetet inovative të trajnimit për palët e interesuara janë zhvilluar bazuar në gjetjet e projektit.

Konsorciumi PAVE përbëhet nga 13 organizata partnere me bazë në 12 vende, si dhe e vë theksin kryesor në hulumtimet me bazë lokale, me njohje të thellë kontekstuale dhe qasje të palëve të interesit brenda rajoneve në studim. Ai bën bashkë partnerë që kanë pika të forta unike dhe komplementare, si dhe fusha të përbashkëta interesi, ashtu që të nxisë mësimin dhe zhvillimin e përbashkët. Në të gjitha vendet, prijësit e komunitetit, si përfaqësuesit e shtetit në fjalë, prijësit fetarë, edukatorët, organizatat rinore dhe organizatat e grave janë konsultuar për të vërtetuar fillimisht planet e hulumtimeve, e më vonë edhe gjetjet e hulumtimit.

Të dhënat empirike u mblodhën në shtatë vende si raste studimi, përmes një përzierjeje qasjesh cilësore, sasore dhe të metodave të përziera, si dhe u krahasuan midis komuniteteve të zgjedhura (p.sh. komunat) të cilat janë të prekura në mënyrë joproporcionale nga ekstremizmi i dhunshëm. Faktorët e cenueshmërisë dhe elasticitetit u identifikuan në nivelin mezo të dinamikës dhe palëve të komunitetit, përgjatë tre grupimeve tematike: ndërlidhja midis ekstremizmit fetar, politik dhe etnik/sektar; ndërveprimi ndërmjet institucioneve fetare dhe atyre publike; dhe ndërveprimin midis narrativave në internet dhe jashtë tij mbi (de)radikalizimin.





Hyrje në hulumtimin PAVE në Kosovë

Hulumtimi në Kosovë, i udhëhequr nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), është kryer në vitin 2021 dhe ka përfshirë 32 intervista dhe katër diskutime në fokus grupe, dhe është kryer në tre lokacione terreni, përkatësisht në tri komuna: Komuna e **Mitrovicës së jugut**,¹ Komuna e **Mitrovicës së veriut**² dhe Komuna e **Podujevës**.³ Këto pika terreni janë zgjedhur sepse ndajnë kryesisht situatë të ngjashme socio-ekonomike, por janë prekur ndryshe nga radikalizimi (QKSS, 2020, KIPRED 2018). Përderisa komunitat e Mitrovicës kanë shënuar ekspozim më të lartë ndaj radikalizimit etno-politik dhe fetar, komuna e Podujevës ka treguar shkallë më të lartë të rezistencës apo elasticitetit ndaj tyre, veçanërisht ndaj radikalizimit fetar.



KCSS
Kosovar Centre for Security Studies

Rrjedhimisht, vendet e përzgjedhura në terren dhanë informacione të rëndësishme për analizën krahasuese se pse disa zona në Kosovë ishin më të cenueshme ndaj radikalizimit në krahasim me të tjerat. Përveç kësaj, zona e Mitrovicës është e ndarë sipas vijave etnike, ndërmjet shqiptarëve të Kosovës (kryesisht myslimanë) dhe serbëve të Kosovës (kryesisht të krishterë ortodoksë).⁴ Ndarja e qytetit ka qenë një burim i vazhdueshëm tensioni etnik, i cili ka nxitur radikalizimin fetar dhe etno-politik. Prandaj, zona e Mitrovicës është një rast i rëndësishëm studimi i ekstremizmit kumulativ dhe se si përdoren identitete të ndryshme në procesin e ndarjes ndërmjet komunitetit shqiptar dhe atij serb, ose se si ekstremizmi etno-politik rrit rrezikun e ekstremizmit fetar, dhe anasjelltas. Në Mitrovicë, radikalizimi i bazuar në identitete fetare (d.m.th. myslimanë dhe ortodoksë të krishterë) rrit rrezikun e ekstremizmit të bazuar në identitetet etnike (shqiptar kundër serb). Me fjalë të tjera, radikalët fetarë përpiqen të ngatërrojnë dy identitetet në mënyrë që të forcojnë narrativat e tyre për të tjerët duke u përpjekur të përcaktojnë treguesit që përbëjnë një shqiptar ose serb "të mirë".

Hulumtimi ka treguar se përkundër progresit të konsiderueshëm, marrëdhëniet ndëretnike në Kosovë mbeten të brishta, veçanërisht mes shqiptarëve dhe serbëve. Për shkak të mungesës së një normalizimi gjithëpërfshirës të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në kuadër të dialogut të lehtësuar nga BE-ja, marrëdhëniet komplekse ndëretnike në Kosovë janë të lehta për instrumentalizim nga grupet radikale, veçanërisht nga e djathta ekstreme, për të nxitur tensione dhe dhunë. Tensionet e rritura etnike shpesh përforcojnë ekstremizmin fetar, ndërsa ushqehen nga njëri-tjetri⁵. Një nga faktorët më të rëndësishëm që duket se shpjegon cenueshmërinë e komunitetit ndaj radikalizimit

¹ Shih Profilin e Mitrovicës së jugut nga OSBE-ja në Kosovë, gjendet tek: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/122118>

² Shih Profilin e Mitrovicës së veriut nga OSBE-ja në Kosovë, gjendet tek: <https://www.osce.org/mission-in-kosovo/122119>

³ Shih Profilin e Podujevës nga OSBE-ja në Kosovë, gjendet tek: <https://www.osce.org/kosovo/13126>

⁴ Komunitat e Mitrovicës së Jugut dhe të Veriut kanë qenë një njësi e vetme administrative, por pas luftës së vitit 1999 në Kosovë, zona u nda në dy pjesë për të parandaluar dhunën ndërmjet komunitetit shqiptar dhe serb. Ndarja e qytetit kalon nëpër lumin Ibër, pjesa veriore e qytetit është e banuar kryesisht nga serbët. Ura mbi lumin Ibër në Mitrovicë është bërë simbol i ndarjes dhe tensioneve etnike në Kosovë që nga viti 1999 dhe ka filluar të karakterizojë vështirësitë e nxitjes së një shoqërie multi-etnike në mjediset pas konfliktit. Në vitin 2007, i Dërguari Special i Kombeve të Bashkuara (OKB) për Procesin e Statusit të Ardhshëm për Kosovën, Martti Ahtisaari, i dorëzoi Këshillit të Sigurimit të OKB-së Propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i njohur zakonisht si Plani i Ahtisaarit, i cili përfshinte një obligim për Kosovën që të zbatojë procesin e decentralizimit dhe të krijojë komuna të reja në zonat me shumicë serbe në Kosovë në mënyrë që të lehtësojë integrimin e komunitetit serb në Kosovë.

⁵ Shih për shembull Publikimin e Projektit PAVE mbi Ekstremizmin Kumulativ në Ballkan dhe rajonin MENA (maj, 2022)

etno-politik në Kosovë është mungesa e një procesi të suksesshëm të ballafaqimit me të kaluarën, gjë që ka çuar në narrativa paralele midis dy komuniteteve (shqiptarët e Kosovës dhe serbët e Kosovës) mbi atë se çfarë ka ndodhur gjatë viteve 1990, si dhe mosnjohje të viktimave të luftës. Kjo shpesh manifestohet përmes mohimit të fakteve të vërtetuara mirë për krimet e tmerrshme të luftës që janë kryer gjatë luftës. Ka një ndjenjë të fortë, veçanërisht në mesin e të rinjve, se mekanizmat e drejtësisë tranzicionale, vendore dhe ndërkombëtare, kanë dështuar të nxjerrin para drejtësisë kriminelët e luftës.⁶

Nga ana tjetër, hulumtimi nga PAVE ka treguar se, në zona si Komuna e Podujevës, rezistenca e komunitetit ndaj radikalizimit është formësuar nga faktorë të ndryshëm socio-politikë, duke përfshirë nivelin e lartë të bashkëpunimit e komunikimit midis institucioneve e prijësve fetarë me institucionet publike.⁷ Përveç kësaj, diskutimet dhe intervistat në grupe fokusi që janë ndërmarrë gjatë punës në terren nga PAVE sugjerojnë se vlerat ose normat personale të prijësve fetarë kanë qenë të rëndësishme për të nxitur rezistencën e komunitetit. Për shembull, në Komunën e Podujevës, disa prijës fetarë promovuan mesazhe respekti dhe mbështetjeje ndaj institucioneve shtetërore dhe kushtetutës së vendit. Në këtë kontekst, një gjetje tjetër e rëndësishme nga puna në terren e PAVE-së lidhur me faktorët që formësojnë rezistencën e komunitetit ndaj radikalizimit, e veçanërisht radikalizimit fetar, është tradita, që do të thotë se komunitetet që i kushtonin rëndësi më të madhe normave tradicionale, si dhe ishin më konservatore ndaj tyre të identitetit etnik hodhën poshtë çdo përpjekje që do të ndryshonte status-kuo-në. Kjo gjetje është në pajtim me hulumtimet e mëparshme që thonë se "rezistenca komunitare është veprim i përbashkët i palëve lokale për të vepruar kundër ekstremizmit të dhunshëm"⁸, ndërsa në këtë kontekst, rezistenca e komunitetit u formësua nga traditat dhe normat e familjes. Shoqëria civile aktive është gjithashtu faktor i rëndësishëm i rezistencës së komunitetit, që kuptohet si vetëdijësim i komunitetit për një fenomen, si dhe veprim i tyre kolektiv për ta kundërshtuar ndikimin e tij. Me fjalë të tjera, komunitetet me shkallë më të lartë të aktivizimit të të rinjve dhe shoqërisë civile, si dhe prania e organizatave joqeveritare që punojnë në çështjet e qeverisjes dhe demokracisë, janë më rezistente ndaj radikalizimit etno-politik dhe fetar. Në rastin e Kosovës, një burim i rëndësishëm i rezistencës ndaj radikalizimit ka qenë besimi i fortë i komunitetit në një të ardhme të vendit të tyre në Bashkimin Evropian (BE), gjë që ka ofruar një gurthemel të rëndësishëm, si dhe një emërues të përbashkët për të gjitha komunitetet në Kosovë, diçka që i bën ata gjithë bashkë, pavarësisht dallimeve, si synim për ta aspiruar. Megjithatë, ndërsa politika e zgjerimit të BE-së bëhet gjithnjë e më e paqartë, kjo mund ta dobësojë më tej kohezionin social në Kosovë.

⁶ Shih për shembull raportin "Perceptimet e të rinjve kosovarë për marrëdhëniet me Serbinë, drejtësinë tranzicionale, pajtimin dhe ballafaqimin me të kaluarën" nga Qendra e Debatit (shkurt, 2021).

⁷ Shih edhe raportin e Agon Demjahës, "Parandalimi i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm: Mësime nga rastet pozitive të komunave të Podujevës dhe të Suharekës" (KIPRED, dhjetor 2018)

⁸ Rudinë Jakupi & Garentinë Kraja 2018. Përcaktimi i dallimeve: Cenueshmëria dhe rezistenca ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Kosovë. Shteti si Rast studimi 3. Berlin/Prishtinë: Fondacioni Berghof dhe Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), f. 1



1. Rekomandime për qeverinë

- Ministria e Punëve të Brendshme, përkatësisht Departamenti për Siguri Publike, duhet të zhvillojë kapacitetet e veta analitike dhe hulumtuese në lidhje me (de)radikalizimin në internet, në mënyrë që institucionet publike të arrijnë të kuptojnë më mirë se si sfera virtuale ndikon në përpjekjet për radikalizimin dhe deradikalizimin. Gjithashtu, në Ministrinë e Punëve të Brendshme duhet të forcohen kapacitetet për parandalimin e përpjekjeve për radikalizim e dezinformim virtual, derisa kjo do të përfshinte mekanizmat e monitorimit dhe reagimin e shpejtë ndaj lajmeve të rreme që synojnë radikalizimin e popullatës. Kjo është posaçërisht e rëndësishme, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet ndëretnike, pasi nganjëherë incidentet e izoluara shpesh priren të keqpërdoren për të promovuar gjuhë të urrejtjes apo mesazhe që synojnë të mobilizojnë reagimin e publikut.
- Qeveria e Kosovës duhet të decentralizojë programet, politikat dhe mekanizmat që synojnë parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (P/CVE), duke deleguar më shumë autoritet dhe burime tek institucionet komunale. Komuna e Mitrovicës së Jugut është i vetmi institucion lokal me program të dedikuar ndaj luftimit të ekstremizmit të dhunshëm, që është miratuar nga Kuvendi Komunal në vitin 2019.⁹
- Qeveria duhet të dallojë kërcënimet e reja ndaj paqes në shoqërinë e vendit nga radikalizimi etno-politik dhe e djathta ekstreme në Kosovë, të cilat nxiten – ndër të tjera – nga narrativat paralele për krimet e luftës që janë kryer gjatë luftës në vitet 1990, si dhe mosmarrëveshjet dypalëshe midis Kosovës dhe Serbisë. Politikat që synojnë të promovojnë pajtimin dhe ballafaqimin me të kaluarën janë masa të rëndësishme për të parandaluar ekstremizmin e ekstremitetit të djathtë në vend. Në këtë kontekst, është me rëndësi të veçantë për qeverinë që të ndërmarrë një fushatë kontaktesh e dialogu me komunitetin serb të Kosovës.
- Programet që mbështesin zhvillimin e të menduarit kritik midis nxënësve të shkollave të mesme, si përmes klubeve aktive të debatit, janë mjete të rëndësishme për të parandaluar fushatat e përgjithshme të radikalizimit që shënjestrojnë të rinjtë. Ministria e Rinisë, Kulturës dhe Sportit duhet të marrë parasysh partneritetin me organizatat e shoqërisë civile të specializuara për zhvillimin e aftësive debatuese mes të rinjve, për të nxitur debatin dhe krijimin e klubeve të debatit në shkollat e mesme.
- Edukimi medial në përgjithësi, si dhe edukimi për mediet virtuale në veçanti, janë shumë të rëndësishme për të përforcuar rezistencën e komunitetit ndaj radikalizimit. Bashkë me këto, qeveria duhet të rrisë mbështetjen për lëndët e edukimit medial për shkollat e mesme, si dhe përmes partneritetit me shoqërinë civile, të organizojë seminare virtuale për edukimin medial në komunitete të ndryshme.
- Lajmet e rreme dhe dezinformatat janë faktorë kyç që kontribuojnë në cenueshmërinë e komunitetit ndaj radikalizimit. Qeveria duhet të përmirësojë kapacitetet për t'iu kundërvënë përpjekjeve për lajme të rreme e dezinformim, përmes bashkëpunimit me mekanizmat ekzistues, si Komisioni i Pavarur për Media (KPM), i cili është përgjegjës për të hartuar e zbatuar politika dhe për të rregulluar të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e individëve dhe subjekteve transmetuese të cilët ofrojnë shërbime mediale audio dhe audiovizuale.

⁹ Shihni për shembull artikullin nga faqja zyrtare e komunës së Mitrovicës së jugut nga viti 2019, që shpall përfundimin e hartimit të Planit Komunal për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm tek të rinjtë”, që gjendet tek: <https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/lajme/komuna-e-mitrovices-pritet-te-behet-me-planin-komunal-per-parandalimin-e-ekstremizmit-te-dhunshem-ne-mesin-e-te-rinje-2020-2022/>



2. Rekomandime për bashkësinë ndërkombëtare

- Procesi i integritit evropian është qenësor për të ruajtur përkushtimin e vendeve të rajonit ndaj nxitjes së kornizës normative liberale-demokratike, si dhe ndaj bashkëpunimit rajonal. Kredibiliteti i BE-së në Kosovë ka vuajtur vitet e fundit, si pasojë e dështimit të liberalizimit të vizave për kosovarët, të cilët mbeten të vetmit qytetarë në Ballkanin Perëndimor që ende iu duhet viza për të hyrë në zonën Shengen. Ekziston një ndjenjë në rritje e publikut në Kosovë se vonesat në liberalizimin e vizave janë të lidhura me paragjykimet e disa shteteve anëtare të BE-së ndaj Kosovës, e kjo ndjenjë pastaj eksploatohet dhe përbën pjesë qendrore të narrativave të radikalizimit fetar dhe të ekstremit të djathtë. Bashkësia ndërkombëtare, e veçanërisht BE-ja, duhet të punojnë për të aktivizuar procesin e integritit evropian për Ballkanin Perëndimor, ndërsa Zyra e BE-së në Kosovë duhet të promovojë më aktivisht projektet e financuara nga BE-ja në vend.
- Bashkësia ndërkombëtare në Kosovë (ambasadat e BE-së, Zyra e BE-së, organizatat ndërkombëtare të zhvillimit si USAID dhe UNDP, etj.) duhet të përmbahen nga veprimet dhe diskursi që nxisin perceptimin se ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi janë në thelb fetarë. Bashkësia ndërkombëtare duhet të marrë parasysh edhe format tjera të radikalizimit, si dhe t'i japë përparësi mbështetjes lokale për deradikalizim përmes fokusimit të prijësit e komunitetit. Një mënyrë për ta bërë këtë është duke ndryshuar gjuhën në deklaratat dhe fjalimet zyrtare për P/CVE, si dhe duke zhvendosur prioritetet e tyre të financimit, gjuhën dhe fokusin në ndërtimin e rezistencës së komunitetit ndaj dezinformatave si dhe çdo forme radikalizimi. Është gjithashtu e rëndësishme të pranohet roli i rëndësishëm që ka luajtur bashkësia islame në Kosovë në promovimin e tolerancës fetare, si dhe gjithashtu të çmohet puna individuale e imamëve që e promovojnë këtë. Komisioni Evropian mund të ndryshojë gjuhën në raportin e tyre vjetor të vendit për Kosovën, kur i referohet ekstremizmit të dhunshëm, për të marrë parasysh ekstremizmin kumulativ dhe forma të tjera të ekstremizmit, e duke tkurrur theksin tek ekstremizmi fetar. Përveç kësaj, duhet të rritet mbështetja përmes financimit për hulumtime, për të kuptuar më mirë ndikimin e ekstremizmit të djathtë në Ballkanin Perëndimor, e veçanërisht në vendet shumetnike si Kosova.
- Duhet të ketë shtytje më aktive për politika më të mira qeveritare dhe komunikim ndërmjet institucioneve publike në nivelin qendror të pushtetit, autoriteve komunale dhe organizatave të shoqërisë civile në trajtimin e P/CVE. Bashkësia ndërkombëtare mund të ndihmojë duke e shtyrë qeverinë për më shumë koordinim dhe komunikim midis sektorit qeveritar dhe atij joqeveritar, por edhe duke marrë pjesë në takime/forume të mundshme konsultative me shumë palë për P/CVE, të cilat do të nxisnin besueshmërinë e mekanizmave apo takimeve të tilla. Bashkësia ndërkombëtare mund të ndihmojë gjithashtu duke njohur dhe duke i dhënë besim iniciativave ose mekanizmave ekzistues të qeverisë që fokusohen në komunikimin dhe koordinimin për çështjet e ekstremizmit të dhunshëm.



3. Rekomandime për shoqërinë civile

- Mekanizmat qeveritarë për P/CVE, por edhe OJQ-të me besueshmëri në Kosovë që punojnë në çështjet e P/CVE, duhet të bashkëpunojnë më aktivisht me prijësit e besimeve dhe ata të komunitetit në fushatat e deradikalizimit. Midis organizatave të shoqërisë civile, ka grupe të OJQ-ve në zhvillim e sipër që punojnë në adresimin e aspekteve ideologjike të procesit të radikalizimit dhe kanë zhvilluar vegla të rëndësishme për të kundërshtuar përdorimin e doktrinës fetare për të justifikuar ekstremizmin e dhunshëm (p.sh., "FolTash").
- Komunitetet fetare dhe organizatat e sapoformuara të shoqërisë civile me bazë në besim duhet të luajnë rol më aktiv në P/CVE, duke përfshirë planifikimin dhe zbatimin e programeve, por po aq me rëndësi, në formësimin e diskursit publik mbi ekstremizmin e dhunshëm. Angazhimi kuptimplotë i prijësve të besimeve dhe besimtarëve fetarë është i rëndësishëm për të kundërshtuar perceptimet e gabuara në publik për punën e shoqërisë civile në P/CVE.
- Organizatat e shoqërisë civile në Kosovë mund të kontribuojnë me shërbime të rëndësishme në procesin e deradikalizimit, si dhe për të kthyerit nga zonat e luftës në Siri dhe Irak, në kuadër të programeve të rehabilitimit dhe riintegrit, por shërbime të tilla duhet të ofrohen përmes partneritetit me institucionet publike. Me rëndësi të veçantë në këtë kontekst janë kujdesi për shëndetin mendor dhe mirëqenia psikosociale, pasi institucioneve publike shpesh u mungojnë kapacitetet dhe burimet për të ofruar mbështetje të tillë. OJQ-të duhet të marrin parasysh zhvillimin e kapaciteteve në këto fusha dhe specializimin në shërbime të tilla, si dhe përmes partneritetit me institucionet publike, të zhvillojnë dhe zbatojnë programe që mbështesin shëndetin mendor dhe mirëqenien psikosociale.
- Organizatat e shoqërisë civile duhet ta kenë prioritet zhvillimin e kapaciteteve për të monitoruar dhe luftuar në mënyrë efektive lajmet e rreme, dezinformimin dhe propagandën e radikalizimit në internet. Kjo duhet të përfshijë edhe zhvillimin e kapaciteteve hulumtuese e monitoruese përmes trajnimeve dhe mundësive të binjakëzimit me institute kërkimore nga shtetet anëtare të BE-së, por edhe përmes asistencës teknike, duke zhvilluar programe softuerike që ndihmojnë në gjurmimin e dezinformatave dhe lajmeve të rreme dhe krijimin e një baze të dhënash. Institutet kërkimore në Kosovë duhet të fokusojnë hulumtimet e tyre në shthurjen e miteve që synojnë të radikalizojnë publikun në vija të identiteteve etnike dhe fetare. Kapacitetet e reja gjithashtu duhet të çojnë në përmirësimin e komunikimit dhe ndërveprimit midis instituteve kërkimore kosovare dhe platformave të mediave sociale, si Twitter dhe Facebook, për t'iu kundërvënë fushatave të lajmeve të rreme dhe dezinformimit.
- Përderisa hulumtimi dhe monitorimi konsiderohen si pika të forta të organizatave të shoqërisë civile në Kosovë, avokimi dhe përkthimi i hulumtimeve të tyre në politika publike është veprim më sfidues. Prandaj, shoqëria civile duhet të promovojë në mënyrë më aktive bashkëpunimin me sektorin publik për të siguruar që programet e tyre të jenë të qëndrueshme, ndërsa mësimet e nxjerra të mund të përkthehen në politika publike.



Referenca

Erblin Hoxha, Ardi Shatri, Vigan Sejdiu and Fatbardhë Kiqina (2021). Kosovar Youth Perceptions of Relations with Serbia, Transitional Justice, Reconciliation and Dealing with the Past. Debate Center.

<https://debatecenter.org/wp-content/uploads/2021/04/Kosovar-youth-perceptions-of-relations-with-Serbia-transitional-justice-reconciliation-and.pdf>

Ramadan Ilazi, Ardit Orana, Teuta Avdimetaj, Bledar Feta, Ana Krstinovska, Yorgos Christidis and Ioannis Armakolas (2022). Online and Offline (De)radicalisation in the Balkans. Working Paper 5.

PAVE Project Publications. www.pave-project.eu/publications/PAVE_870769_D5.1_publication_layout.pdf

Kosovar Centre for Security Studies (KCSS) (2020). Kosova Resilience Index – Violent Extremism in Kosova: What Community Resilience Can Teach Us?

https://qkss.org/images/uploads/files/Resilient_paper_eng_641966.pdf

Samet Dalipi and Shala Krenar (2016). The Role of Decentralization on Security Improvement and Peace-building in Kosovo”. Prishtina: Friedrich-Ebert-Stiftung. <https://library.fes.de/pdf-files/bueros/kosovo/13856.pdf>

Kosovar Institute for Policy Research and Development (KIPRED) (2018). Prevention of Radicalization and Violent Extremism: Lessons from the Positive Cases of Podujevo and Suhareka Municipalities.

[www.kipred.org/repository/docs/Prevention_of_Radicalism_and_Violent_Extremism_-_Positive_Cases_-_Podujevo_and_Suhareka_\(1\)_2_851758.pdf](http://www.kipred.org/repository/docs/Prevention_of_Radicalism_and_Violent_Extremism_-_Positive_Cases_-_Podujevo_and_Suhareka_(1)_2_851758.pdf)

Municipality of Mitrovica South (2019). Municipal Plan for Prevention of Violent Extremism among Youth.

<https://kk.rks-gov.net/mitrovicjeejugut/news/komuna-e-mitrovices-pritet-te-behet-me-planin-komunal-per-parandalimin-e-ekstremizmit-te-dhunshem-ne-mesin-e-te-rinjve-2020-2022/>

Isak Svensson and Desirée Nilsson (2022). Cumulative Extremisms in the Balkans and MENA Region.

Synthesis Report. PAVE Project Publications. https://www.pave-project.eu/publications/PAVE_870769_D3.3_publication_layout.pdf

Sead Turčalo, Jelena Brkić-Šmigoc, Mirza Smajić, Veldin Kadić, Muamer Hirkić, Maja Halilovic Pastuovic, Goran Tepšić, Nemanja Džuverović and Gillian Wylie (2022). Cumulative Extremisms in the Balkans. Working Paper 1. PAVE Project Publications.

https://www.pave-project.eu/publications/PAVE_870769_D3.1_publication_layout.pdf